



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 06, Datë 15.01.2026

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“NOVA SOLAR SYSTEM” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “e”, 5, pika 1, gërma “e”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.01.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 7/1 prot., datë 13.01.2026, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 7 prot., datë 06.01.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 të Rregullores për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, dhe “d”; për pikën 1.3 gërmën “c”; si dhe pikën 2.5.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi, rezulton se nevojitet të plotësohet dhe sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “b”**: Duhet të depozitohet dëshmia e penalitetit për vetë shoqërinë.
- **gërma “c”**: Në dokumentin e strukturës organizative duhet të saktësohen ortakët dhe të plotësohet vendimi i organeve drejtuese për miratimin e strukturës. Po ashtu shoqëria duhet të depozitojë informacion mbi stafin aktual efektiv.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “a”**: Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin që nuk ka detyrime tatimore të

- pashlyera ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të depozitojë vendimin e organeve drejtuese të saj, ku të dedikohet shuma përkatëse për ushtrimin e aktivitetit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI